



KËSHILLI KOMBËTAR SHQIPTAR
НАЦИОНАЛНИ САВЕТ АЛБАНСКЕ НАЦИОНАЛНЕ МАЊИНЕ
NATIONAL COUNCIL OF ALBANIAN NATIONAL MINORITY

Numër .370-3/19

Data 15.11.2019

Bujanoc

Në bazë Nenit 113. paragrafi 2. pika 1. të Ligjit për Këshillat Kombëtare të Pakicave Kombëtare (Fletorja zyrtare R.S. 72/2009,20/2014 - vendimi i GJK 55/2014 dhe 47/2018) dhe neni 34. të Statutit të Këshillit të kombëtar shqiptar nr.520.44-1/18 e vendimit 370-3 të datës 15.11.2019 të Këshilli Ekzekutiv i Këshilli Kombëtar Shqiptar shpallë:

KONKURS PUBLIK

Për financimin e programeve vjetore dhe projekteve të veprimtarisë së rregullt të Këshillit Kombëtar Shqiptar si financimi ose bashkëfinancimi i programit dhe i projekteve në fushën e arsimit, kulturës, informimit dhe përdorimit zyrtar të gjuhës dhe shkrimit shqip;

Lëndë e këtij konkursi publik është shpërndarja e mjeteve të orientuara në vendimin mbi Planin Financiar të Këshillit Kombëtar Shqiptar për vitin 2019, në shumë prej **4.000.000,00 (katër milion)** dinarë, për realizimin e programeve vjetore dhe projekteve të organizatave të shoqërisë civile, shoqatave që janë themelues pjesëtarët e pakicës kombëtare shqiptare.

Vlera maksimale e mjeteve për programe, gjegjësisht projekte individuale nuk mund të jenë më shumë se **500.000,00 (pesëqind mijë)** dinarë, ndërsa ajo minimale **20.000,00 (njëzetmijë)** dinarë.

Të drejtën e pjesëmarrjes në konkursin publik për financimin e programeve dhe projekteve për shoqatat joqeveritare e cila i përmbushë këto kushte:

Krahas fletëparaqitjes nevojiten edhe këto dokumente:

1. Plotësimi i formularit për aplikim 1 dhe 2;
2. Informacion mbi organizatën aplikuese –cv;
3. Statutin e aplikuesit (organizatës);
4. Kopja e regjistrimit të aplikantit në autoritetin kompetent me një përshkrim të veprimtarisë për të cilën është regjistruar aplikanti; (fushëveprimi në kompetencat KKSH);
5. Aktin e Themelimit të Organizatës;
6. Certifikatë (konfirmim , kopje) të shoqatës , organizatës, OJQ-ës i regjistruar në regjistrin e autoriteteve kompetente ;
7. Plani dhe programi i punës për vitin **2019**;
8. Numri i llogarisë rrjedhëse aktive dhe NIT i organizatës;

Konkursi është i hapur nga data 20.11.2019 deri më 30.11.2019.

Aplikacionit ti bashkëngjiten dokumentet, veç e veç. Formularët e plotësuar për aplikim të dorëzohen në 2 kopje, me përjashtim të aktit të themelimit dhe të statutit në zyrat e Këshillit Kombëtar Shqiptar në Bujanoc .

Vërejtje: Valide do të konsiderohen vetëm se projekt dokumentacionet e dërguara në kohë dhe të plota sipas konkursit, ndërsa nuk do të shqyrtohen projektet me dokumentacion jo të plotë dhe jashtë afatit.

Këshilli Kombëtar Shqiptar, K.Pemoviq 237, 17520 Bujanoc, R. Serbi
Tel/fax: 00381 17 653 264, e-mail: kksh.bujanoc@gmail.com kksh.lugina@outlook.com



Kryetar

Ragmi Mustafi